



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:089168
Datë: 20.02.2025
Numri i dokumentit: 06873622

C.nr.547/23

GJYKATA THEMELORE GJILAN, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale Ronita Halimi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, M.H., nga Gjilani, me adresë Rr. "E..A.." nr.1., të cilin e përfaqëson avokat Faruk Brestovci nga Gjilani, sipas autorizimit të dhënë nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas, kundër të paditurës KRU "Hidromorava" Sh.A, me seli në Gjilan, me objekt të kontestit lirimi nga pagesa e borxhit në vlerë 2895 Euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës, më datë 19.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni civil, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike.

II. Hidhet poshtë e palejuar padia e paditësit, M.H., kundër të paditurës KRU "Hidromorava" Sh.A, Komisionit për Zgjidhje të Ankesave-Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit Prishtinë, lidhur me çështjen e kontestit lirimi nga pagesa e borxhit, dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Paditësi, M.H., ka ushtruar padi ndaj të paditurës KRU "Hidromorava" Sh.A, Komisionit për Zgjidhje të Ankesave-Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit Prishtinë, lidhur me çështjen e lirimit nga pagesa e borxhit, në vlerë 2,920.00 Euro. Në padi ka theksuar se është përfitues i ndihmës sociale dhe është i liruar nga disa pagesa siç është pagesa e rrymës, andaj do të duhej të lirohej edhe nga borxhi.

Gjykata, duke u kujdesur për kompetencën e saj lëndore gjeti se çështja e cila është objekt i kësaj padie nuk është çështje gjyqësore, por çështje administrative, për vendosjen e të cilës kompetent është Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit në Prishtinë.

Neni 4 paragrafi 3 pika 3.2 e Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ka përcaktuar që Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit ka kompetencë për "përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta dhe të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve".

Paditësi, në petitumin e padisë ka kërkuar që të miratohet padia e tij, dhe të lirohet nga borxhi i pagesës së mëtejme të ujit, deri në një vendim qeveritar.

Me nenin 3 paragrafi 1 pika 1.8 të Rregullores Nr. 09/2019 Për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve përcaktohet se “Komisioni – nënkupton komisionin për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve lidhur me shërbime të ujit, si organ përfundimtar në procedurën administrative.”

Me nenin 6 paragrafin 2 të kësaj Rregullore përcaktohet se “Komisioni shqyrton pranueshmërinë, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e ankesave të palëve, në përputhje me LPPA dhe nxjerrë vendim me shkrim për çdo ankesë të shqyrtuar.” Ndërsa neni 7 paragrafi 1 përcakton të drejtën për ankesë ku thuhet se “Të drejtën për të parashtruar ankesë tek Komisioni e ka çdo konsumator i cili pretendon se të drejtat e tij janë shkelur nga ofruesi i shërbimeve, me veprim, mosveprim apo keqadministrim gjatë ofrimit të shërbimeve”, andaj, në bazë të dispozitave të lartcekura, paditësi duhet t’i drejtohet Komisionit për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve lidhur me shërbimet e ujit, si organ përfundimtar në procedurën administrative me ankesë lidhur me çështjen në fjalë dhe ky Komision të nxjerrë vendim lidhur me këtë çështje ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 6 të Rregullores së lartcekur “Komisioni shqyrton pranueshmërinë, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e ankesave të palëve, në përputhje me LPPA dhe nxjerrë vendim me shkrim për çdo ankesë të shqyrtuar.” Andaj, paditësi si konsumator është dashur t’i drejtohet këtij organi.

Në nenin 15 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 09/2019 Për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve përcaktohet se “Kundër vendimit të Komisionit nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit mund të iniciojë padi në gjykatën kompetente për çështje administrative, brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimin të vendimit.”

Andaj, nga të lartcekurat, në kuptim të neneve 17. 1 “Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur” dhe nenit 19, “Secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore”, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
C. nr.547/23, datë 19.02.2025

G j y q t a r i,

Arben Xheladini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.